



BULETINI



NËNTOR 2024



KAMPET E TË RINJVE NË MBARË KOSOVËN

Në nëntor, seria e kampeve të të rinjve arriti në përfundim.

Prizren (Nëntor 1-3):

I organizuar në Hotel Lakeside, ky kamp u fokusua në unitet, bashkëpunim dhe mirëkuptim ndërmjet të rinjve nga komunitete të ndryshme. Pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime mbi sfidat e komunitetit, duke punuar së bashku për të gjetur zgjidhje idesh dhe për të përmirësuar aftësitë e tyre gjuhësore. Një pikë kulmore kulturore ishte ekskursioni në qytetin e vjetër të Prizrenit, ku grupi eksploroji historinë e pasur dhe trashëgiminë e gjallë të qytetit.





Prevallë (Nëntor 15-17):

Kampi final në Prevallë mbledhi së bashku pjesëmarrës nga kampet e mëparshme për të reflektuar mbi rrugëtimin e tyre. Nëpërmjet diskutimeve në grup, aktiviteteve kreative dhe leksioneve gjuhësore, pjesëmarrësit forcuan aftësitë e tyre të komunikimit dhe nxitën mirëkuptimin më të thellë të ndërsjellë.



Rreth Projektit YESS Projekti "Rinia e Fuqizuar përmes Shkollave dhe Shoqërive Gjithëpërfshirëse" (YESS), i financuar nga Fondi për Ndërtimin e Paqes të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe i zbatuar nga UNICEF dhe IOM në Kosovë, synon të rrisë kohezionin social, tolerancën dhe diversitetin brenda komuniteteve të Kosovës.



PUNËTORI MBI TË DREJTËN MJEDISORE



Me mbështetjen e UNDP, dhe në bashkëpunim me Education Code, Organizata ACDC vazhdoi në nëntor me seminare mbi të drejtën mjedisore. Këto punëtori u fokusuan në të drejtat mjedisore, praktikat e qëndrueshme dhe kornizat ligjore, duke promovuar bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve multietnike për të trajtuar së bashku sfidat mjedisore.

PROJEKT I RI

Këtë nëntor, ACDC lansoi projektin "Kanvasi i Kulturës në Kosovën Veriore", një iniciativë e re për të forcuar mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet komuniteteve. Ky projekt financohet nga Programi Zviceran për Bashkëpunim.

Anketa e Angazhimit Kulturor

Si pjesë e projektit, ACDC nisi anketën për të eksploruar perceptimet dhe pjesëmarrjen në aktivitetet kulturore në veri të Kosovës. Anketa është në dispozicion në serbisht dhe shqip. Shikoni [këtu](#)!

ACDC PUBLIKON ARTIKUJ PËR MONITORIMIN E KRIMEVE TË LUFTËS

 [ENG](#)

 [SRB](#)

 [ALB](#)

OJQ ACDC ka publikuar dy artikuj të rinj si pjesë e projektit "Lehtësimi i Bashkëpunimit Ndëretnik përmes Monitorimit dhe Raportimit mbi Rastet e Krimeve të Luftës". Ky projekt, i udhëhequr nga Internews Kosova në partneritet me ACDC, synon të kontribuojë në drejtësinë tranzicionale duke dokumentuar seancat gjyqësore për krimet e luftës në Kosovë dhe duke rritur ndërgjegjësimin si tek institucionet gjyqësore ashtu edhe tek publiku i gjerë.

PODCAST: TRAJTIMI I SFIDAVE BUROKRATIKE



Katarina Axhanqiq, nënkryetare e Komunës së Mitrovicës së Veriut u shfaq në një podcast të publikuar nga ACDC në bashkëpunim me Radio Kontakt Plus. Diskutimi u fokusua në sfidat me të cilat përballen qytetarët gjatë aplikimit për dokumente personale. Kjo iniciativë është realizuar në kuadër projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe të Kosovës", financuar nga INL.

DIALOG PËR MJEDISIN

Menaxheri i programit të OJQ ACDC Slobodan Stoshic, mori pjesë në sesionin e Bisedave Harmonizuese të mbajtur në Mitrovicë, me fokus në angazhimin e të rinjve në qëndrueshmërinë mjedisore. Mbështetur nga BE-ja dhe UNDP-ja dhe organizuar nga OJQ REC dhe ADRC, sesioni theksoi rëndësinë e ruajtjes së mjedisit përmes përpjekjeve bashkëpunuese në komunitetet etnikisht të ndryshme.

DISKUTIM PËR GJUHËN E URREJTJES DHE OP ED

Moderuar nga Ines Ajloviq Mihajloviq, ky panel hulumtoi sfidat dhe zgjidhjet e mundshme për të luftuar gjuhën e urrejtjes brenda komuniteteve. Panelistët ishin Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i OJQ ACDC, së bashku me aktivistë dhe gazetarë, të cilët theksuan ndikimin e thellë të gjuhës së urrejtjes në marrëdhëniet ndëretnike dhe sfidat e paraqitura nga keqinformimi në shoqërinë moderne.

Për më tepër, Ines Aljović Mihajloviq shkroi një op-ed mbi gjuhën e urrejtjes, duke diskutuar ndikimin e rrezikshëm mbi komunitetet dhe duke theksuar rolin e medias në luftimin e dezinformimit dhe retorikës përçarëse. [LINK](#)

AVANCIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT: UEBFAQJA E RE E AVOKATIT TË POPULLIT

Nëntori shënoi fillimin e faqes së re të internetit të Institucionit të Avokatit të Popullit, duke mundësuar paraqitjen e ankesave online. Kjo platformë lehtë e qasshme për përdoruesit, e mbështetur nga UNMIK-u dhe e zbatuar nga ACDC, lehtëson raportimin efikas të shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke rritur qasjen e publikut në drejtësi.

<https://oik-rks.org>



Në nëntor, pesë organizata, duke përfshirë ACDC, i kërkuan Prokurorisë Themelore të Mitrovicës që të informojë publikun mbi hetimin për sjelljen e dyshuar të policisë. Lexoni njoftimin e plotë për media.

ACDC gjithashtu dënoi ndalimin e Jovana Radosavljeviq, duke theksuar ndikimin e incidenteve të tilla në besimin në strukturat lokale të sigurisë.



Një grup organizatash joqeveritare nga veriu i Kosovës, përfshirë ACDC, NSI, AKTIV, CASA dhe InTER, dënoi fuqishëm sulmin ndaj Kanalit Ibar-Lepenc në Zubin Potok, që ndodhi në fund të nëntorit.

Ne i bëjmë thirrje të gjitha institucioneve përkatëse të hetojnë të gjitha rrethanat e sulmit dhe të identifikojnë përgjegjësit. Për më tepër, u bëjmë thirrje organizatave ndërkombëtare që të sigurojnë veprim të duhur nga ana e policisë dhe të parandalojnë keqpërdorimin e këtij rasti për të rritur më tej presionin ndaj komunitetit serb në Kosovë.

Lexoni të gjitha komunikatat për shtyp në faqen tonë të internetit.



ACDC në media

Drejtori Ekzekutiv i ACDC Dushan Radakoviq dhe zyrtarja e programit Ines Aljoviq Mihajloviq u paraqitën në TV Most për të diskutuar mbi rritjen shqetësuese të ngacmimeve seksuale në veri të Kosovës.



Për më tepër, Ines Aljoviq Mihajloviq u shfaq në serialin "Heroji našeg doba" ("Heronjtë e kohës sonë") nga "Medija Centar Čaglavica së bashku me Milica Radovanoviq, duke diskutuar çështjen në rritje të ngacmimeve seksuale në veri të Kosovës.



Ines Aljoviq Mihajloviq gjithashtu ndau përvojat dhe perspektivat e saj personale në një intervistë për Al Jazeera Balkans dhe Blic, duke theksuar ndikimin e ngacmimit në jetën e përditshme dhe mungesën e reagimit institucional.

